



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0562

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " INFINITT " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me perde për shkolla me numër të prokurimit 632-26-4052-1-2-1, me 04/09/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE " INFINITT " SH.P.K. me nr. 2026/0562 , e datës 03/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me perde për shkolla me numër të prokurimit 632-26-4052-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA E GJAKOVËS, ndërkaj aktiviteti i prokurimit Furnizim me perde për shkolla me numër të prokurimit 632-26-4052-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " INFINITT " SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.05.2026 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me perde per shkolla" me nr. të prokurimit: "632-26-4052-1-2-1",

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: xx,xxx €

Me 10.07.20206. KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënje të kontrates ku është rekomanduar për kontratë” NTP BLETARIA EGZONI & ATREBIL GROUP SH.P.K.

Me 15.07.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 23.07.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.08.2026, OE INFINITT " SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0562, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhenje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ INFINITT " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Neni 1- Qellimi Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës Neni 59- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve Neni 60- Kriteret për dhenie të kontratës Neni 65.5- Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve Neni 67- Provat Shkresore Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 70- Standardet për sigurimin e cilësive Neni 108/A- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve pika 6 Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 10.07. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë grupin e OE NTP BLETARIA EGZONI & ATREBIL GROUP SH.P.K. Me 13.07. kemi kërkuar qasje në dokumentet zyrtare dhe me 14.07. AK na ka ofruar qasjen sipas kërkesës sone. Nga dokumentet të cilat kemi pranuar konstatojmë se AK/ komisioni vlersues ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm për arsyejet si në vijim: Grupi i OE nuk ka dorezuar deshmi Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527- 1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) sipas kërkesës për pozicionin 1 dhe 2 në paramasë. Poashtu grupi i OE rezulton të jetë i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriterin lidhur me kapacitetin teknik&profesional pasi që nuk ka ofruar asnjë deshmi për realizimin e kontratave të ngjashme/ furnizim me perde.

OE ka dorezuar disa referenca për liderin e grupit Bletaria të Egzoni të cilat nuk janë të natyrës se këtij aktiviteti të prokurimit: OE ka dorezuar deshmi referenca për furnizim me koshere

bletesh, furnizim me dyll , blerja e paisjev per bletari, furnizim me mekanizem bujqesor, furnizim me paisje bujqesore, centrifuga etj. Zyra e prokurimit ne pergjigje/refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim ka cekur se grupi i OE te rekomanduar per kontrate kane dorezuar deshmi-referenca per furnizime, nuk e mohojme se kane dorezuar dhjetera referenca mirepo ato nuk plotesojne kriterin e paraqitur ne dosjen e tenderit lidhur me kapacitetin teknik&profesional ku eshte kerkuar, citoj: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime të natyrës së ngjajshme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Referencat e dorezuara nuk jane te kesaj natyre rrjedhimisht keto deshmi nuk paraqesin furnizime te ngjashme prandaj grupi i OE OE NTP BLETARIA EGZONI & ATREBIL GROUP SH.P.K.eshte dashur te eliminohet si i papergjegjshem. Grupi OE te rekomanduar per kontrate poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka plotesuar kerkesat e pershtatshmerise sipas kerkeses ne dosjen e tenderit. Kriteri i dosjes se tenderit lidhur me kerkesat e pershtatshmerise eshte si ne vijim: III.2.1) Kërkesat e përshtatshëmrisë: Dëshmia e kërkuar dokumentare

1.Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit-aneks 2. 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet kopja 3. Vertetim nga Gjykata se operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallur fajtor dhe vertetim qe kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore - kërkohet origjinali . Kerkesa eshte perpiluar konform nenit 65.5 te LPP-se Grupi i OE nuk ploteson kriterin pasiqe ka dorezuar vertetimin tatimor ne emer te liderit Bletaria Egzoni me nr serik 1001361599 te dates 09.07.2026. ne kete menyre eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka ofruar deshmi se ne momentin e ofertimit ka qene i pergjegjshem sipas nenit 65 te LPP-se. Poashtu certifikata e gjykates per partnerin e konzorciumit OE Atribil group eshte e leshuar me 06.07.2026. Në këtë aktivitet të prokurimit, data e hapjes se ofertav është 24.06.2026, ndërsa vertetimi tatimor i dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate mban datën 09.07.2026 dhe certifikata e Gjykates per anetarin e grupit me 06.07.2026. çka nënkupton se eshte leshuar pas datës se hapjes se ofertav dhe nuk pasqyronë gjendjen faktike të pranueshmërisë së tenderuesit ankues në momentin apo afatin e kërkuar. Si i tille, ky dokument nuk mund të konsiderohet dëshmi e vlefshme dhe eshte në kundërshtim me kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara nga AK

Autoriteti kontraktues eshte dashur te shqyrtoje se a ploteson OE i rekomanduar kerkesat e pershtatshmerise para dates se ofertimit konform nenit 65.5 te LPP-se dhe kerkeses ne DT. Në përputhje me nenin 65 paragrafi 5 i Ligjit për Prokurimin Publik, periudha kohore në të cilën Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kriterin e “pranueshmërisë” lidhet drejtpërdrejt me periudhën që menjëherë i paraprine datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Kjo dispozitë ligjore nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të jetë i pranueshëm pikërisht në datën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe jo pas kësaj date. Në rastin konkret, kërkesa e AK ka qenë e vendosur në përputhje të plotë me nenin 65, paragrafi 5 i LPP-së, ndërsa dokumentet përkatëse Vertetimi i Administratës Tatimore dhe Certifikata e Gjykate do të duhej të ishin të lëshuara para ose deri ne ditën e hapjes se ofertav. Dorëzimi i vertetimit tatimor pas kësaj date nënkupton se Operatori Ekonomik do të mund të bëhej “i pranueshëm” vetëm pasi të ishte vënë në dijeni për rezultatin e procedurës, gjë që është në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Operatorët Ekonomikë të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit duhet të jenë të rregullt në përmbushjen e obligimeve tatimore para datës së ofertimit, duke dëshmuar kështu stabilitetin dhe likuiditetin e tyre ekonomik. Në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të LPP-së, AK ka obligim ligjor të vlerësoj të papërgjegjshëm çdo tenderues i cili nuk paraqet certifikatat apo dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar se nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji. Nga shqyrtimi i fakteve rezulton se tenderuesi ankues nuk ka dorëzuar dëshmi në pajtim me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, ashtu siç janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT. Lidhur me kete qeshtje komisioni rregullativ per prokurim publik ka nxjere interpretim ligjor me 22.11.2022. citojme interpretimin nr 6. 6. 22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlihet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë. Pasiqe jemi ballafaquar me shtate te njejte ne AK tjera bashkangjesim interpretimin e KRPP-se te cilin kemi pranuar me 11.03.2026. Poashtu nga qasja ne dokumente zyrtare konstatojme se dhe dy OE tjera Zebra store dhe Gama consulting jane te papergjegjshem pasiqe nuk kane dorezuar Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527- 1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) sipas kerkeses per poziconin 1 dhe 2 ne paramase si dhe OE Gama consulting nuk ka dorezuar deklaraten per specifikime teknike sipas kerkeses ne nenin 3.1 te FDT-se. Ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim AK ka theksuar se keto deshmi/ Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527- 1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) nuk jane kerkuar tek kerkesat per pjesmarrje por te paramasa dhe parallogaria dhe si te tilla nuk shqyrtohen ne vleresim se a i ploteson OE apo jo, shtrohet pyetja se si eshte siguruar

AK qe OE i rekomanduar per kontrate ploteson standardet per sigurimin e cilesise dhe ne implementim/ realizim te projektit do ti dorezoje keto deshmi. Kjo eshte dyshuese duke pasur parasysh dhe faktin se lideri i grupit te OE eshte kompani e cila meret me koshere te bleteve dhe furnizime te ngjashme e jo me perde. Në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës autoriteti kontraktues eshte dashur të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Mare parasysh faktet e lartcekura konstatojme se AK/komisioni vleresues pa te drjete ka rekomanduar per kontrate grupin e OE te cilet rezultojne te jene te papergjegjshem. Shkelje tjeter procedurale e ndodhur ne kete aktivitet te prokurimit eshte se AK/Zyra e prokurimit nuk ka respektuar nenin 108/a pika 6 te LPP-se pasi qe shqyrtimi i kerkeses per ri-shqyrtim eshte bere jashte afatit ligjor 3-5dite, AK ka kthyer pergjigje/refuzimin e kerkeses per ri-shqyrtim pas 8diteve

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.

AK/Zyra e prokurimit më 10.07. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë grupin e OE NTP BLETARIA EGZONI & ATREBIL GROUP SH.P.K.

Më 13.07. kemi kërkuar qasje në dokumentet zyrtare dhe më 14.07. AK na ka ofruar qasjen sipas kërkesës sonë.

Nga dokumentet të cilat kemi pranuar konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Grupi i OE nuk ka dorëzuar dëshmi Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527-1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) sipas kërkesës për pozicionin 1 dhe 2 në paramasë.

Poashtu grupi i OE rezulton të jetë i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriterin lidhur me kapacitetin teknik&profesional pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi për realizimin e kontratave të ngjashme/furnizim me perde.

OE ka dorëzuar disa referenca për liderin e grupit Bletaria të Egzoni të cilat nuk janë të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit: OE ka dorëzuar dëshmi referenca për furnizim me koshere bletësh, furnizim me dyll, blerja e pajisjeve për bletari, furnizim me mekanizëm bujqësor, furnizim me pajisje bujqësore, centrifuga etj.

Zyra e prokurimit në përgjigje/refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka cekur se grupi i OE të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar dëshmi-referenca për furnizime, nuk e mohojmë se kanë dorëzuar dhjetëra referenca, mirëpo ato nuk plotësojnë kriterin e paraqitur në dosjen e tenderit lidhur me kapacitetin teknik&profesional ku është kërkuar, citoj:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime të natyrës së ngjashme për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Referencat e dorëzuara nuk janë të kësaj natyre, rrjedhimisht këto dëshmi nuk paraqesin furnizime të ngjashme, prandaj grupi i OE OE NTP BLETARIA EGZONI & ATREBIL GROUP SH.P.K. është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm.

Grupi OE të rekomanduar për kontratë poashtu është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesës në dosjen e tenderit.

Kriteri i dosjes së tenderit lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë është si në vijim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit-aneks 2. 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet kopja 3. Vërtetim nga Gjykata se operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallur fajtor dhe vërtetim që kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë - kërkohet origjinali.

Kërkesa është përpiluar konform nenit 65.5 të LPP-së.

Grupi i OE nuk plotëson kriterin pasi që ka dorëzuar vërtetimin tatimor në emër të liderit Bletaria Egzoni me nr. serik 1001361599 të datës 09.07.2026. Në këtë mënyrë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka ofruar dëshmi se në momentin e ofertimit ka qenë i përgjegjshëm sipas nenit 65 të LPP-së. Poashtu certifikata e gjykatës për partnerin e konzorciumit OE Atribil Group është e lëshuar më 06.07.2026.

Në këtë aktivitet të prokurimit, data e hapjes së ofertave është 24.06.2026, ndërsa vërtetimi tatimor i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë mban datën 09.07.2026 dhe certifikata e Gjykatës për anëtarin e grupit më 06.07.2026. Çka nënkupton se është lëshuar pas datës së hapjes së ofertave dhe nuk pasqyron gjendjen faktike të pranueshmërisë së tenderuesit ankues në momentin apo afatin e kërkuar.

Si i tillë, ky dokument nuk mund të konsiderohet dëshmi e vlefshme dhe është në kundërshtim me kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara nga AK.

Autoriteti kontraktues është dashur të shqyrtojë se a plotëson OE i rekomanduar kërkesat e përshtatshmërisë para datës së ofertimit konform nenit 65.5 të LPP-së dhe kërkesës në DT.

Në përputhje me nenin 65 paragrafi 5 i Ligjit për Prokurimin Publik, periudha kohore në të cilën Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kriterin e “pranueshmërisë” lidhet drejtpërdrejt me periudhën që menjëherë i paraprin datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Kjo dispozitë ligjore nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të jetë i pranueshëm pikërisht në datën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe jo pas kësaj date.

Në rastin konkret, kërkesa e AK ka qenë e vendosur në përputhje të plotë me nenin 65, paragrafi 5 i LPP-së, ndërsa dokumentet përkatëse Vërtetimi i Administratës Tatimore dhe Certifikata e Gjykatës do të duhej të ishin të lëshuara para ose deri në ditën e hapjes së ofertave.

Dorëzimi i vërtetimit tatimor pas kësaj date nënkupton se Operatori Ekonomik do të mund të bëhej “i pranueshëm” vetëm pasi të ishte vënë në dijeni për rezultatin e procedurës, gjë që është në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Operatorët Ekonomikë të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit duhet të jenë të rregullt në përmbushjen e obligimeve tatimore para datës së ofertimit, duke dëshmuar kështu stabilitetin dhe likuiditetin e tyre ekonomik.

Në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të LPP-së, AK ka obligim ligjor të vlerësojë të papërgjegjshëm çdo tenderues i cili nuk paraqet certifikatat apo dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar se nuk skualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji.

Nga shqyrtimi i fakteve rezulton se tenderuesi ankues nuk ka dorëzuar dëshmi në pajtim me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, ashtu siç janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT.

Lidhur me këtë çështje Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka nxjerrë interpretim ligjor më 22.11.2022. Citojmë interpretimin nr. 6.

22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE-të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlihet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për

shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Pasi që jemi ballafaquar me situatë të njëjtë në AK tjera, bashkëngjisim interpretimin e KRPP-së të cilin e kemi pranuar më 11.03.2026.

Poashtu nga qasja në dokumente zyrtare konstatojmë se dhe dy OE tjera Zebra Store dhe Gama Consulting janë të papërgjegjshëm pasi që nuk kanë dorëzuar Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527-1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) sipas kërkesës për pozicionin 1 dhe 2 në paramasë, si dhe OE Gama Consulting nuk ka dorëzuar deklaratën për specifikime teknike sipas kërkesës në nenin 3.1 të FDT-së.

Në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim AK ka theksuar se këto dëshmi/Certifikatat EU ISO 14001:2015, Certifikat EN 527-1.2.3 BS OHSAS 18001 2017 (Certifikatat të jenë kopje e noterizuar) nuk janë kërkuar tek kërkesat për pjesëmarrje, por te paramasa dhe parallogaria dhe si të tilla nuk shqyrtohen në vlerësim se a i plotëson OE apo jo.

Shtrohet pyetja se si është siguruar AK që OE i rekomanduar për kontratë plotëson standardet për sigurimin e cilësisë dhe në implementim/realizim të projektit do t'i dorëzojë këto dëshmi.

Kjo është dyshuese duke pasur parasysh dhe faktin se lideri i grupit të OE është kompani e cila merret me koshere të bletëve dhe furnizime të ngjashme e jo me perde.

Në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës autoriteti kontraktues është dashur të ftojë operatorët ekonomikë për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktet e lartcekura konstatojmë se AK/komisioni vlerësues pa të drejtë ka rekomanduar për kontratë grupin e OE të cilët rezultojnë të jenë të papërgjegjshëm.

Shkelje tjetër procedurale e ndodhur në këtë aktivitet të prokurimit është se AK/Zyra e prokurimit nuk ka respektuar nenin 108/a pika 6 të LPP-së pasi që shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim është bërë jashtë afatit ligjor 3-5 ditë, AK ka kthyer përgjigje/refuzimin e kërkesës për rishqyrtim pas 8 ditëve.

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartcekura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhur deri tek dhënia e kontratës për OE të papërgjegjshëm dhe trajtimi si OE të pasuksesshëm për OE Zebra Store dhe Gama Consulting, të cilët është dashur të eliminohen si të papërgjegjshëm, kompanisë sonë si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit i është mohuar e drejta e fitimit të paramenduar nga kjo kontratë.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas shoshitjes së provave dhe fakteve të aprovojë ankesën e kompanisë sonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim, ri-vlerësimi i ofertave nga AK të bëhet në harmoni me kriteret/kërkesat e parashtruara në njoftimin për

kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.08.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0562 ndërsa me datë 14.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0562, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e " INFINITT " SH.P.K . eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0562 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1-Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar, pasi nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton se Certifikata EU ISO 14001:2015, EN 527-1.2.3 dhe BS OHSAS 18001:2017 janë përcaktuar në mënyrë të qartë si dokumente që duhej të dorëzoheshin domosdoshmërisht me ofertë. Megjithatë, duke qenë se këto standarde janë përfshirë në specifikimet teknike të Paramasës, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që gjatë vlerësimit të ofertave të verifikojë përputhshmërinë teknike të produkteve të ofruara me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2-Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e operatorit ekonomik ankues, sipas të cilit grupi i operatorëve ekonomikë i propozuar për dhënie të kontratës nuk e ka përmbushur kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional, pasi nuk ka dëshmuar përvojë në realizimin e kontratave të natyrës së ngjashme.

Nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë përfundimin me sukses të kontratave për furnizime të natyrës së ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Nga shqyrtimi i listës së kontratave dhe referencave të dorëzuara nga lideri i grupit, NTP "Bletaria Egzoni", rezulton se kontratat e paraqitura kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me

koshere bletësh, pajisje për bletari, dyll, centrifuga, mekanizëm dhe pajisje bujqësore, të cilat nuk përbëjnë furnizime të natyrës së ngjashme me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit. Vetë fakti që kontratat janë kontrata furnizimi nuk mjafton për përmbushjen e kriterit, pasi Dosja e Tenderit ka kërkuar furnizime të natyrës së ngjashme dhe jo çdo lloj furnizimi.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përvojën e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit dhe ky pretendim ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3-Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e operatorit ekonomik ankues, sipas të cilit grupi i operatorëve ekonomikë i propozuar për dhënie të kontratës nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë, pasi vërtetimet nga Administrata Tatimore dhe certifikatat e Gjykatës janë lëshuar pas datës së hapjes së ofertave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik ka dorëzuar Deklaratën nën Betim me ofertë, ndërsa vërtetimet nga Administrata Tatimore dhe Gjykata janë dorëzuar para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se, në përputhje me nenin 65 paragrafi 5 të LPP-së, operatori ekonomik duhet të jetë i pranueshëm në periudhën që menjëherë i paraprin datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim të verifikojë nëse dokumentet e dorëzuara dëshmojnë përmbushjen e kushteve të pranueshmërisë për periudhën relevante të përcaktuar me ligj.

Megjithatë, vetëm fakti që vërtetimet janë lëshuar pas datës së hapjes së ofertave nuk përbën, në vetvete, bazë ligjore për eliminimin e operatorit ekonomik, pasi Ligji nuk kërkon që këto dokumente të jenë të lëshuara para datës së hapjes së ofertave, por që ato të dëshmojnë gjendjen e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 4-Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e operatorit ekonomik ankues lidhur me mungesën e certifikatave EU ISO 14001:2015, EN 527-1.2.3 dhe BS OHSAS 18001:2017, si dhe mungesën e deklaratës për specifikimet teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se grupi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Deklaratën për Specifikimet Teknike, të nënshkruar dhe vulosur, me të cilën ka deklaruar përputhshmërinë e produkteve të ofruara me kërkesat e Aneksit 1 dhe Paramasës. Për këtë arsye, pretendimi në pjesën që ka të bëjë me mungesën e kësaj deklarate nuk është i bazuar.

Sa i përket certifikatave të kërkuara për pozicionet përkatëse të Paramasës, eksperti shqyrtues vlerëson se deklarata e operatorit ekonomik nuk e zëvendëson paraqitjen e certifikatave, nëse Paramasa ka kërkuar shprehimisht dorëzimin e tyre. Në këtë pjesë, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 5-Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e operatorit ekonomik ankues lidhur me tejkalimin e afatit ligjor për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim pas afatit të përcaktuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik.

Rrjedhimisht, eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar afatin ligjor për vendosjen mbi kërkesën për rishqyrtim, çka përbën shkelje procedurale të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me perde per shkolla” me nr. të prokurimit: "632-26-4052-1-2-1",

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues dhe panevoj që të njëjtat të përsëriten sërish ankesën e OE ankues e aprovon si pjesërisht të bazuar, dhe anulohet njoftimi për dhënje të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e

prezantuarë si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: